



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR MAT

Nr. Serial 000004

AUTORIZIM
PËR VEPRIMTARI NDËRTIMORE NË BRIGJE

Nr. 10 Prot., datë 25 / 11 / 2025

Miratuar me:
VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT LUMOR MAT
Nr.7, datë 11/11/2025

Emri i individit/subjektit:

BORDI I KULLIMIT LEZHË

I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/ NIPT):

K68315510P

Baseni Lumor:

MAT

Kodi i Trupit Ujor:

RW351231

Qarku:

LEZHË

Bashkia/ Njësia administrative:

Bashkia Kurbin / Njësia Administrative Milot

Koordinatat:

X₁=481322.79 Y₁=4618677.55 Z₁=0

X₂=481730.89 Y₂=4618546.35 Z₂=0

Lloji i burimit ujqor ku do të kryhet veprimtaria:

Lumi Mat

Lloji i veprimtarisë që do të kryhet:

Mbrojtje nga gërryerjet e lumit Mat në Skuraj

Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka): **Sipas Vendimit dhe kushteve të posaçme të autorizimit.**

Periudha e vlefshmërisë: **Nga data e miratimit deri në fillimin e zbatimit në terren, në çdo rast jo më shumë se 2 (dy) vjet.**

Hyrja në fuqi: **Pas publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve.**

KRYETARI

TAULANT MALSHI



Kushtet e posaçme të autorizimit për veprimtari ndërtimore në brigje

1. Të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë autorizimi;
3. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;
4. Të instalojë dhe mirëmbajë me shpenzimet e veta pajisjet për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organi përkatës që ka lëshuar autorizimin (kur është e aplikueshme);
5. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
6. Autorizimi nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
7. Të respektohen kushtet higjieno – sanitare dhe të mbrojtjes së mjedisit (kur është e aplikueshme);
8. Të mos dëmtojë brigjet dhe shtratin e burimit ujor;
9. Të mos ndryshojë rrjedhën natyrore të burimit ujor;
10. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse të ujit;
11. Të lejojë rrjedhjen ekologjike të miratuar (kur është e aplikueshme);
12. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujor, ose në brigje në rast të një aksidenti, apo incidenti;
13. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin ujor në gjendjen e mëparshme;
14. Të mos çënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla;
15. Të sigurojnë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për të mundësuar përdorimin e burimit ujor nga subjekte të tjerë;
16. Të zbatojë parimet dhe kushtet e tjera për veprimtarinë, të përcaktuara në ligjin për burimet ujore.